



REPUBLIKA E KOSOVË
Drejtoria e Inspeksionit
Glllogoc, me 05.06.2017



RAPORT PËR MUAJIN MAJ 2017

Gjatë këtij muaji me rëndësi të veçantë janë inspektuar ndërtimet pa leje dhe transportuesit ilegal, duke vazhduar edhe me kontrollë të Ligjit të duhanit. Për realizimin e këtyre punëve në mënyrë më efektive është inspektuar edhe gjatë ditëve të vikendit, ndërsa për kontrollë të Ligjit të duhanit është inspektuar ditëve të javës pas orarit të punës (një herë gjatë javës). Në vazhdim po ju sjellë punët e kryera nga secili Inspektor sipas lëmive të tyre përkatëse:

Inspektori Sanitar sipas planit operativ ka inspektuar ambulancat shëndetsore në të gjitha pikat ekzistuese dhe ka vazhduar me kontrollë të subjekteve hoteliere për kontrollë të Ligjit të duhanit.

Inspektori i Ndërtimit përveq inspektimit të ndërtimeve pa leje, ka bërë inspektime sipas kërkesës gjatë fazave të ndërtimit me leje si dhe inspektim të objekteve në parkun e biznesit sipas kërkesës së Inspektorëve të nivelit qendror (për leje të ndërtimit dhe çertifikatë të përdorimit).

Inspektori i Komunikacionit ka vazhduar me kontrollë të Operatorëve ilegal dhe me masat e radhës-fletëparaqitje dhe konfiskimin e automjeteve të tyre.

Inspektorët e Tregut kanë bërë mbikqyerjen e tregut të gjelbër në veqanti si dhe inspektimin e tregtarve lëvizës.

Inspektori Financiar ka evidentuar bizneset rreth kryerjes së obligimeve të takses komunale duke vazhduar me masat e radhës-vërejtje për pagesë.

Inspektori i Ambientit ka kryer inspektime të deponive ilegale bashk me komisionin nga CEAE(organizata mjedisore) dhe kompania "Pastrimi", ka kryer inspektime në shqyrtim të kërkesave të palës dhe verifikimin e bizneseve rreth hyrjes së tyre në sistem të menagjimit të mbeturinave.

Në vazhdim po paraqesim një pasqyrë të punës në shifra:

Lëmia Inspektuese	Procesverbale	Vërejtje për pagesë	Aktvendime	Fletëparaqitje	Gjopa mandat.	Kërkesa	Pëlqim për biznes	Konfiskim i Targave	Konfiskime të automjeteve
I.Sanitare	38				2		3		
I.Tregut	19		3			3			
I.Financiare	27	6							
I.komunikacionit	11			12				1	3
I.Ndërtimit	38		7	1	5				
I.Ambientit	26					8			
Gjithsej	159	6	10	13	7	11	3	1	3